



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Nr._____.Prot.

Peqin, më ___/12/2023

PROJEKT-VENDIM

Nr _____ Datë _____.12.2023

“Mbi miratimin e kontratës së shërbimit publik “Për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Peqin në Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit”

Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit i propozojnë Këshillit të Bashkisë Peqin, bazuar në:

Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenet 8, 9 dhe 54;

Ligjin nr. 10 463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;

Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

Propozim:

1. Të miratojë lidhjen e kontratës së *“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Peqin”*, në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit, midis Bashkisë Peqin dhe Shoqërisë “ECO-ELB” Sh.A., sipas draftit bashkëlidhur.
2. Të miratojë ndryshimet në buxhetin e bashkisë Peqin që reflekton efektin financiar zbatimit të kësaj marrëveshje.
3. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij projekt-vendimi.
4. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

KRYETARI I BASHKISË

/ Bukurosh MAÇI /